



**Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës
Savez Sportsko Recreativnih Ribolovaca Kosova
Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen**

**RREGULLORE NR. 01 / 2024 PUNËN E KUVENDIT TË FEDERATËS SË
PESHKATARVE SPORTIV REKREATIV TË KOSOVËS**

Prishtine Korrik 2024

Në përputhje me nenin 19 të Statutit të **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**, Bordi i FPSRK-së me datë PROPOZOJ këtë:

RREGULLORE PUNËN E KUVENDIT TË FEDERATËS SË FEDERATËS SË PESHKATARVE SPORTIV REKREATIV TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit të FPSRK-së (në tekstin e mëtutjeshëm Kuvendi), mënyra e realizimit të drejtës për të qenë delegatë i Kuvendit, kompetencat dhe obligimet e kryesuesit të mbledhjes, si dhe çështje të tjera të cilat janë me interes për punën e Kuvendit dhe trupave punuese të tij.

Neni 2

1. Kuvendi është organi më i lartë i udhëheqjes në FPSRK-së i cili vendos në seanca për çështje nga fushë veprimtaria e vet.
2. Kuvendi është i rregullt, zgjedhor dhe i jashtëzakonshëm.
3. Kuvendin e përbëjnë nga një delegatë i çdo klubi të regjistruar sipas Ligjit për Sport dhe akteve tjera normative të FPSRK-së, si dhe nga dy delegatë të Shoqatave aktive (trajnerëve dhe gjyqtarëve).

Neni 3

1. Për përgatitjen e mbledhjeve dhe zbatimin e Vendimeve të Kuvendit, janë përgjegjës:
2. Bordi i FRK-së, Kryetari dhe Sekretari .

II. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE OBLIGIMEVE TË DELEGATIT

Neni 4

1. Delegati i realizon të drejtat dhe obligimet e tij në përputhje me Statutin e FPSRK-së dhe këtë Rregullore.
2. Klubin - Shoqatën në Kuvendin e FPSRK-së e përfaqëson personi i autorizuar i Klubit – Shoqatës i shënuar në formularin e regjistrimit të Klubeve – Shoqatave.

Neni 5

1. Verifikimin e mandateve të delegatëve e bënë Komisioni për verifikim të cilin e zgjedhë Kuvendi para fillimit të mbledhjes.
2. Komisionin verifikues duhet ta përbejnë tre (3) anëtar.

3. Nëse Komisioni verifikues konstaton se personi i cili përfaqëson klubin në Kuvend nuk është i shënuar në formularin e regjistrimit të emrave të dërguar nga klubet, personi i tillë nuk ka të drejtë ta përfaqësojë klubin në Kuvend.
4. Nëse Komisioni verifikues konstaton se personi i cili përfaqëson Shoqatën në Kuvend nuk është i shënuar në formularin e regjistrimit të emrave të dërguar nga Shoqata përmes Kuvendit, personi i tillë nuk ka të drejtë ta përfaqësojë Shoqatën në Kuvend.
5. Nëse Komisioni verifikues konstaton se personi i cili përfaqëson klubin, është nën masën e suspendimit apo dënimit e shqiptuar nga organet e FPSRK-së, nuk ka të drejtë ta përfaqësojë klubin apo Shoqatën në Kuvend.

Neni 6

Për punën e vetë delegati i përgjigjet Kuvendit dhe Klubit - Shoqatës të cilën e përfaqëson.

Neni 7

1. Mandati i delegatëve të Kuvendit zgjat 4 vjet dhe nuk është i kufizuar.
2. Delegati i Kuvendit mund të revokohet.
3. Delegati revokohet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për zgjedhjen e tij.
4. Mandati i delegatit të rizgjedhur zgjat deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta.
5. Për revokimin e delegatit vendos Kuvendi me shumicë votash.

Neni 8

Delegati ka të drejtë që në mbledhjet e Kuvendit të marrë pjesë në diskutim për çështjet të cilat janë në rend të ditës, të propozojë amendamente në aktet normative të cilat i miraton Kuvendi, të propozojë shqyrtimin e çështjeve të cilat janë me interes për zhvillimin e sportit te peshkimit në aspekt profesional.

Neni 9

Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit, i bartë vetë delegati.

Neni 10

Ne mbledhjet e Kuvendit munde te marrin pjese edhe mysafiret e ftuar pa të drejtën e votës.

III. MBLEDHJA E KUVENDIT

Neni 11

1. Mbledhja e rregullt e Kuvendit mbahet një herë në vit dhe sipas nevojës, ndërsa Kuvendi zgjedhor çdo katër vjet.
2. Mbledhjen e Kuvendit e thërret kryetari.
3. Mbledhjen e Kuvendit kryetari mund ta thërras sipas nevojës.

Neni 12

1. Mbledhjen e Kuvendit e thërret kryetari më së paku 7 ditë para datës së caktuar me thirrje të veçantë.
2. Në thirrje për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit është e obligueshme të përcaktohet rendi i ditës, data, koha, si dhe vendi i mbajtjes së Kuvendit.
3. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit e udhëheq kryetari, në qoftë se Kuvendi nuk vendos ndryshe.

Neni 13

Mbledhjen zgjedhore dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit e udhëheq kryetari dhe kryesia e punës, të cilën e përbëjnë anëtarët e Bordit të FPSRK-së.

Neni 14

1. Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e thërret kryetari, në bazë të kërkesës me shkrim të:
 - Bordit të FPSRK-së,
 - Këshillit mbikëqyrës
 - Të dy të tretave të numrit të delegatëve në Kuvend.
2. Nëse kryetari nuk e thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit në afat prej 15 ditësh nga dita e kërkesës së parashtruar, mbledhjen do ta thërras sekretari i FPSRK-së dhe do të veprojë në kuptim të dispozitave të statutit të FPSRK-së .
3. Në mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit mund të vendoset vetëm për atë për çka është thirrë.

Neni 15

1. Kuvendi vendos në mënyrë të plotfuqishëm nëse në të marrin pjesë më tepër se gjysma e delegatëve të autorizuar, dhe vendimet janë të plotfuqishëm nëse votojnë më shumë se gjysma e delegatëve të pranishëm, përveç nëse është fjala për:
 - zgjedhjen dhe revokimin e kryetarit të FPSRK-së,
 - zgjedhjen dhe revokimin e anëtarëve të Bordit të FPSRK-së dhe

- ndërrimet dhe plotësimet e dispozitave të Statutit, për të cilat vendoset me 2/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend.
2. Për punën e Kuvendit mbahet procesverbali, i cili ruhet në administratë të FPSRK-së , nën mbikëqyrje të sekretarit të FPSRK-së .

Neni 16

Thirrja për mbledhje të Kuvendit me rendin e përcaktuar të ditës, si dhe materiali i përgatitur me shkrim u dërgohet më së voni 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes:

- Delegatëve të Kuvendit,
- Federatës së FPSRK-së të Kosovës.
- Departamentit për Sport të Kosovës

Neni 17

Kuvendi:

- Aprovon Statutin rregulloret dhe aktet e tjera normative të FPSRK-së;
- Përcakton politikën, planin dhe programin e punës me qëllim të avancimit të lëmit;
- Aprovon planin financiar dhe llogarinë përfundimtare;
- Bën ndarjen e mirënjohjeve, lavdratave dhe shpërblimeve;
- Zgjedh dhe revokon kryetarin;
- Zgjedh dhe revokon anëtarët e Bordit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës;
- Vendos për lutje dhe ankesa;
- Vendos mbi anëtarësimin e klubeve dhe Shoqatave në FPSRK-së;
- Shqyrton raportin e punës së Bordit të FPSRK-së dhe Shoqatave aktive;
- Përcakton kahet e punës së organeve dhe anëtarësisë së FPSRK-së;
- Themelon organe të përhershme dhe të përkohshme me vendim të posaçëm, duke iu përcaktuar fushëveprimin, detyrat dhe afatet e kryerjes së punëve konkrete;
- Vendos mbi pushimin e punës së Federatës;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statut dhe me akte të tjera të FPSRK-së .

Neni 18

1. Mbledhja e Kuvendit të rregullt thirret më së largu 15 ditë para mbledhjes ndërsa materiali duhet të dërgohet, shtatë (7) ditë para Kuvendit.
2. Ftesa për Kuvend të rregullt duhet të dërgohet më së largu 15 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 7 ditë para Kuvendit.
3. Ftesa për Kuvend të rregullt zgjedhorë duhet të dërgohet më së largu 30 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 21 ditë para Kuvendit. Ndërsa nominimi i kandidatëve për postin e kryetarit , dhe anëtarëve të Bordit bëhet 10 ditë para Kuvendit.
4. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin kryetari respektivisht Bordi i FPSRK-së, 2/3 të anëtarëve të Kuvendit si dhe Këshilli Mbikëqyrës kur konstaton shkelje ligjore

në veprimtarin e FPSRK-së Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërras kryetari, në afat prej 30 ditëve prej ditës së kërkesës, në të kundërtën, Kuvendin mund ta thërras edhe iniciuesi.

Neni 19

Mbledhjen e hapë dhe e kryeson Kryetari i FPSRK-së, në mungesë të kryetri i Bordit, i cili mbledhjen e udhëheqë së bashku me kryesinë e punës, të cilën e anëtarë me i vjetër i Kuvendit.

Neni 20

1. Para se të votohet për rendin e ditës , kryetari duhet të konstatojë se a janë plotësuar kushtet sipas Statutit për punë dhe vendimmarrje.
2. Nëse gjatë mbledhjes kryetari dyshon se nuk ekziston kuorumi, do të urdhëroj rinumërimin e delegatëve.
3. Rinumërimi do të bëhet edhe nëse një gjë të tillë e kërkon njeri prej delegatëve, me qëllim të përcaktimit të kuorumit.

Neni 21

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit pa të drejtën e votës.

Neni 22

1. Askush nuk mundë të flasë në mbledhje para se të kërkojë dhe të marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
2. Delegati ka të drejtë që në lidhje me rendin e ditës të diskutojë pesë (5) minuta.
3. Delegati nuk ka të drejtë që për të njëjtën pikë të rendit të ditës të diskutojë më shumë se dy (2) herë.
4. Delegati i cili është përmendur gjatë diskutimit në mbledhje ka të drejtën e replikës e cila nuk mundë të zgjasë me shumë se dy (2) minuta.

Neni 23

Në mbledhje duhet të shqyrtohet çdo pikë e rendit të ditës, para se të vendoset në lidhje me të. Gjatë diskutimit delegati nuk ka të drejtë të diskutojë, jashtë pikës së rendit të ditës e cila është në diskutim e sipër.

Neni 24

Nëse delegati edhe pas vërejtjes së kryesuesit të mbledhjes vazhdon të diskutojë jashtë pikës së rendit të ditës, kryesuesi duhet t'i merr fjalën.

Neni 25

Nëse në mbledhje diskutohet për aktet normative, të cilat i miraton Kuvendi, delegatët janë të obliguar që, nëse kanë propozime në lidhje me plotësimin ose ndryshimin e akteve të propozuara, të i japin propozimet me shkrim para fillimit të mbledhjes së Kuvendit.

Neni 26

Në mbledhjet e Kuvendit mbahet procesverbali, të cilin e mbanë delegati i zgjedhur nga Kuvendi dhe e nënshkruajnë kryetari dhe procesmbajtësi.

Neni 27

Mbledhjet e Kuvendit janë publike dhe në to mundë të marrin pjesë përfaqësuesit e medimeve elektronike dhe të shkruara.

Neni 28

1. Zgjedhja e organeve të Federatës bëhet me vota të fshehta, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe.
2. Nëse kemi të bëjmë me Kuvend zgjedhor, atëherë duhet të zgjidhet Komisioni zgjedhor prej tre (3) anëtarësh, i cili do të bënë numërimin pas votimit i cili duhet të jetë i mbyllur.

Neni 29

1. Të gjithë kandidatët për anëtarë të Bordit kur kemi të bëjmë me Kuvendin zgjedhorë duhet të jenë të nominuar nga klubet në formularin e posaçëm të FPSRK-së dhe i cili duhet të dërgohet në zyrën e FPSRK-së 3-të ditë para Kuvendit.
2. Anëtarë e Bordit e FPSRK-së mund të zgjidhen në të njëjtën funksion maksimum për tre mandate, dhe në kohën e zgjedhjes apo rizgjedhjes, nuk duhet ta ketë arritur moshën prej 68 (gjashtëdhjetë e tetë) vite. Zgjedhja për herë të parë në Bordin e FPSRK-së e anëtarëve të Bordit bëhet me anë te nominimit me shkrim nga klubi apo shoqata anëtare gjegjëse.

Neni 30

1. Kryetari zgjidhët me mandat katërvjeçar, zgjedhjen e kryetarit të FPSRK-së mund ta propozoj çdo organizatë e bashkuar e sportit te peshkimit apo Bordi i FPSRK-së nga mandati i skaduar.
2. Kandidati për kryetar duhet ta ketë pëlqimin – përkrahjen e së paku 10 anëtarëve të Kuvendit me shkrim të deponuar në zyrën e FPSRK-së së paku 3 ditë para mbajtjes së kuvendit.
3. Nëse vjen deri te shkurtimi i mandatit te Bordit para skadimit te afatit katërvjeçar, mandati i kryetarit te ri zgjat vetëm për kohën e mbetur te mandatit, sipas ciklit olimpik

Neni 31

1. Nënkryetari po ashtu zgjidhet me mandat katërvjeçar, duhet të jetë i propozuar nga klubet, dhe kandidati i cili kandidohet për këtë post, nuk mund të kandidohet edhe për një post tjetër.
2. Anëtarë e Bordit e FPSRK-së mund të zgjidhen në të njëjtën funksion maksimum për tre mandate, dhe në kohën e zgjedhjes apo rizgjedhjes, nuk duhet ta ketë arritur moshën prej 68 (gjashtëdhjetë e tetë) vite. Zgjedhja për herë të parë në Bordin e FPSRK-së e anëtarëve të Bordit bëhet me anë te nominimit me shkrim nga kryetari FPSRK-së, klubi apo shoqata anëtare gjegjëse.

Neni 32

1. Kuvendi i zgjedhë 7 anëtarë (me mandat katërvjeçar), në radhët e personave të propozuar për Bordin e FRK-së, 30% duhet të jenë persona të gjinisë femërore (nese ka mundesi dhe ka sportiste peshkimi).
2. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit bëhet me vota të fshehta. Lista përfshinë emrat e kandidatëve dhe postet e tyre në Bord. Kandidati i cili kandidohet për një post, nuk mund të kandidohet edhe për një post tjetër.
3. Vendi i postit të anëtarit i cili zgjidhët nga radhët e minoriteteve, është e drejt e rezervuar nëse nuk janë prezent në Kuvend.
4. Kryetari i Bordit është edhe Kryetar i Kuvendit.
5. Nëse vjen deri te shkurtimi i mandatit te Bordit para skadimit te afatit katërvjeçar, mandati i Bordit te ri zgjat vetëm për kohën e mbetur te mandatit, sipas ciklit olimpik.

Neni 33

Ndërsa të gjithë anëtarët e bordit (Kryetari, 5 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi dhe dy Kryetarët e shoqatave, janë pjesë e Bordit 7 anëtarësh me çrast do të publikohen në mbledhjen e parë të radhës së Bordit të FPSRK-së

Neni 34

Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 36

Vendimet e Kuvendit janë obliguese për të gjithë anëtarët dhe organet e Kuvendit.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së.



Milaim Vitia

Kryetar i Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës